

JEHONA QË LETËRSIA I JEP TRASHËGIMISË KULTURORE

Prof. asoc. Dr. UKË BUÇPAPAJ

Fakluteti i Gjuhëve të Huaja

Universiteti i Tiranës

uk.bucpapaj@unitir.edu.al

Msc. LINDITA KASAJ

Fakluteti i Gjuhëve të Huaja

Universiteti i Tiranës

lindita.kasaj@unitir.edu.al

ABSTRACT

The article deals with the echo and the important role that literature has for preserving and transmitting the values of our national heritage. We will deal with Albanian fortifications over the centuries, giving examples such as the "Castle" a novel by Ismail Kadare and "The Siege of Shkodra" a novel by Marin Barleti which mainly talk about the war between the Albanians and the Ottomans in the 15th century. Castles were not only places where wars were fought, but in times of peace, various activities took place. There you could hear the hammers of the blacksmiths, who prepared tools, other craftsmen produced baked clay vessels, tanned leather, worked on bronze and silver ornaments. Civilizations were born when man became aware that, more than what he found ready in nature, he should create, and above all preserve what others had created. As an example of the great civilizational transformations we will treat the novel Ali Pasha Tepelena, by the author Sabri Godo. According to the author: "Before starting this third edition, I went and saw the places where Ali lived and ruled, I saw the cities, the forts."

Keywords: castles, national heritage, fortifications, literature.

Letërsia ka një rol shumë të rëndësishëm në ruajtjen dhe transmetimin e vlerave të trashëgimisë sonë kombëtare. Romanet historike, librat arkeologjikë, mitet dhe legjendat na japin shumë informacione të përshkruara me kujdes dhe në një mënyrë të bukur që vetëm letërsia mund ta bëjë. Do të shohim dhe kuptojmë se kështjellat nuk ishin vetëm vende ku bëheshin luftëra, por në kohë paqeje zhvilloheshin aktivitete të ndryshme.

Kushdo që ishte zot i tyre sundonte krahinat përreth, kontrollonte rrugët dhe shtigjet. Ushtritë e huaja që vinin për të pushtuar vendin duhej të merrnin kështjellat.

Pushtuesit i rrethonin kështjellat për muaj të tërë, derisa u mbaronte uji dhe ushqimi. Shpesh armiku, i lodhur dhe i thyer, kthehej prej nga kishte ardhur. Rreth mureve të kështjellave kanë ndodhur shumë ngjarje. Historia ka regjistruar vetëm disa prej tyre dhe shumë gjëra janë harruar prej kohësh. Por ka ngjarje që kanë lënë gjurmë mes mureve të rrënuara dhe dheu që i mbulon i ka ruajtur për trashëgimtarët e atyre që punuan dhe luftuan në kështjella. Kështjellat kanë histori dhe legjenda të bukura. Ne do të fillojmë me disa nga kështjellat ilire.

Amantia që në lashtësi njihej si qyteti i sportit, ishte më i bukuri i tërë qyteteve të amantëve ishte kryeqendra. Shkëmbi gëlqeror mbi të cilin ngrihej qyteti zgjatej nga lindja në perëndim, sikur donte të shkëputej nga mali i frikshëm i Tartarit. Vetë natyra ishte kujdesur për mbrojtjen e qytetit të mbushur plot me qytetarë të Amantias dhe të qyteteve të tjerë që vinin për të parë lojrat.

Butroti është i njohur për legjendat e bukura. Për vendbanimet ilire përmendim edhe kalatë të cilat shërbenin edhe si fortifikime mbrojtëse në rast rreziku. Është e rrallë të gesh qytete antike, për të cilat tregohen aq shumë legjenda, sa për Butrotin. Sipas shkrimtarit të lashtë, Stefan Bizantinit, kështjella ishte themeluar nga Heleni, vëllai i heroit të famshëm trojan, Hektorit: "tregojnë legejndën se emrin ia vuri Heleni, kur duke udhëtuar nga Troja për në Perëndim, bëri fli gjatë zbritjes së tij në Epir. Kau që po përgatitej për fli, i shpëtoi thikës kur po e thernin dhe iku me të shpejtë përmes detit; hyri në një gjë dhe doli në breg të një toke të pabanuar dhe atje ra dhe ngordhi. Atëherë Heleni e mori si fatthënie dhe i vuri emrin Buthrotos, siç thotë Teukri nga Kyziku. Ngjashmëria e emrit Bous, që në greqisht do të thotë dem,

i ka nxitur disa arkeologë që ta lidhin emrin e Butrotit me atë legjendë.

Vizita legjendare e heroit trojan, Eneut, në Butrint, i shërben poetit të madh romak, Virgjilit, për të shkruar një nga këngët më të bukura të poemës së tij, Eneida. Në këtë poemë ai tregon rrugën e gjatë që bën Eneu që nga Troja, të cilën e braktis mes flakëve, duke mbajtur mbi supe babain etij plak, Ankizin, dhe duke tërhequr për dore të birin Julin. Virgjili e përshkruan në këtë mënyrë ardhjen e Eneut në Butrot:

*“Pra duke ecur shoh një Trojë të vogël
dhe një pergam në ngjasim të atij të madhit,
dhe një përrua të thatë, të quajtur Ksanth,
dhe aty në prag puth edhe Portën Skea
Edhe trojanët bashkë me mua kënaqen
Me një qytet vëlla, kurse vetë mbreti
Po i priste nën portikët e gjerë”.*

Butrinti nuk kishte hyrë rastësisht në poezinë e Virgjilit. Edhe pse një qytet i vogël, ai ishte bërë mjaft i famshëm në shekullin I para Krishtit, ai u vizitua nga disa nga njerëzit më të rëndësishëm të kohës. Vetë Cezari kishte ardhur në Butrot në fillim të vitit 48 para Krishtit. Sipas ditarit të tij, ai kishte krijuar një bazë në Butrot për të furnizuar ushtrinë e tij me ushqime.

Në romanin historiko-letrar: “Arhondi i fundit i Butrintit” i Halil Shabanit flet për zbarkimin e ushtrisë romake në Butrot.

“Zbarkimi i ushtrisë romake, në bregdetin ilir, nga Lisus, Dyrah, Apolloni dhe Orikum, e më vonë në Grai e Butrot, si dhe largimi i zotit nga qyteti i diellit, ishin dy goditje shumë të mëdha për Nikanorin. Po bëhej gati për të fjetur, por sytë nuk i mbylleshin. Mendja e tij po bluante vetëm ato dy ngjarje. Butroti për të ishte një nga qytetet më të fortifikuara, i mbrojtur jo vetëm nga tre mure rrethuese, por edhe nga pengesat natyrore: liqeni, deti dhe kanali i gjerë. Banorët mund të mbroheshin nga muret e larta, madje vetëm me shigjeta harqesh e shtizash ose me gurë. Lajmi, i përhapur shpejt nga miqtë e tij se “Njësitë e para romake hynë në Butrot”, i ra si rrufe mbi kokë.”

Mund të shohim se një luftë e madhe u organizua në Butrint me ardhjen e romakëve. Kalatë e shumta në të gjitha viset e territorit ilir, numri i madh i shpatave, helmetave dhe armëve të tjera në varrezat e luftëtarëve ilirë, si dhe përshkrimet e luftëtarëve që gjejmë në burimet e shkruara antike, dokumentojnë mjaft bindshëm. luftërat e ilirëve ndër shekuj.

Marin Barleti dhe “Rrethimi i Shkodrës”

Jo rastësisht në krye të letërsisë sonë janë dy vepra që mund të quhen dy monumente të kësaj periudhe të lavdishme: “Rrethimi i Shkodrës” dhe “Historia e jetës dhe e veprave të Gjergj Kastriotit Skënderbeut”, të dyja të shkruara nga i yni. autor Marin Barleti. Barleti tregon motivet që e shtynë të angazhohej për një vepër kaq të madhe e të rëndësishme.

Barleti thekson detyrën ndaj “atdheut” që të mos i mohojë diçka të drejtë dhe të ndershme..., që ai e ka kërkuar nga unë”, të mos “të shurdhohë... atij vendi kaq të dashur për mua.

Po kush ishte Barleti? – do të pyesë me të drejtë lexuesi. Ajo që dimë për datat e jetës së tij janë vetëm këto: Ai ishte një prift nga Shkodra, autor i tre veprave latine “Rrethimi i Shkodrës”, botuar në Venedik më 1504; “Historia e jetës dhe e veprave të Skënderbeut”, botuar në Romë midis viteve 1508 - 1510 dhe e një “Përmbledhje e jetës së papëve dhe perandorëve”, botuar në Romë midis viteve 1508-1510. Vetë Barleti ishte dëshmitar i rrethimit të parë të Shkodrës nga osmanët, sepse ishte aty, ndërsa në rrethimin e dytë mori pjesë në luftime. Më vonë emigroi në Itali. Barleti e shkroi këtë libër për të inkurajuar shqiptarët për një ndërmarrje të re ushtarake. Luftën që bëjnë shkodranët për mbrojtjen e qytetit të tyre, autori e konsideron si pjesë përbërëse të asaj që populli shqiptar ka bërë prej dhjetëra e dhjetëra vitesh kundër pushtimit osman. Vetë ngjarjet flasin për këtë mjaft qartë.

Barleti e ka ndarë romanin “Rrethimi i Shkodrës” në tre kapituj, ose siç quheshin dikur, në tre libra. Libri i parë përmban një parathënie kushtuar Dukës së Venedikut. Libri i dytë nis me përpyekjet e Mehmetit II për pushtimin e Shkodrës. Libri i tretë tregon dështimin e të gjitha sulmeve dhe vendimin e Sulltanit për t’u larguar dhe marrë qytetin

nga uria. Në pak faqe, Marin Barleti ka ringjallur një botë, një epokë të tërë. Para së gjithash, ai është historian dhe mendonte se historia duhet t’i shërbejë të vërtetës, të jetë mësuese e jetës, t’i mësojë njerëzit dhe gjithashtu t’i shërbejë së bukurës.

“Kështjella” – Ismail Kadare

Kështu edhe “Kështjella” është kompozim e strukturë e gjetur në historinë e popullit. Është historia e rrethimit dhe qëndresës së shumë kështjellave, po simbolikisht është historia e qëndresës shqiptare. Kështu ndodhi në epokën e Skënderbeut me ushtritë e sulltanëve osmanë. Kështu ka ndodhur në Shkodër, në Dibër, në Kosovë, në Martanesh, në Kurvelesh e Mallakastër, në Plavë e Guci, e Lëkurës.

Duke e parë qëndresën shqiptare në plan monumental, autori ka synuar një gjuhë lakonike, një shkurtësi sintetike të kronikës dhe përsiatje të kështjellarit në fillim të çdo kapitulli. Ato, si tërësia e veprës, janë një mësim nga historia, nga realiteti i kohës dhe paralajmërim për të ardhmen.

“Në të dalë të dimrit, -n্থuhet në kronikën e kështjellarit që në hyrje të romanit, - kur delegatët e sulltanit u larguan, ne e kuptuam që lufta ishte e pashmangshme. Ata na bënë gjithfarë presinësh që ne të pranonim vasalitetin. Në fillim përdorën lajkat dhe premtimet, pasataj na akuzuan si renegatë dhe mosmirënjohës. Më në fund, na kërcënuan hapur se do të na mposhtnin me anë të luftës. Ju u besoni shumë mureve të kështjellave tuaja, na thanë ata, por edhe në qoftë se ato mure janë vërtet të papushtueshme, atëherë ne do të bëjmë që sa herë të vijë koha e korrjeve dhe e ditëve të lëmit, ju të shikoni qiellin sikur të ishte fushë e mbjellë dhe hëna t’ju duket si drapër....

Nuk kaloi as një muaj kur të gjithë vasalët e sulltanit, pasi morën letra prej tij, njëri pas tjetrit i prenë marrëdhëniet me ne”²

Më tej nga fundi i romanit:

“Ata provuan çdo gjë kundër nesh, duke filluar nga topat gjigandë gjer te minjtë e infektuar. Ne qëndruam dhe po qëndrojmë. E dimë që

² Alfred Uçi(-), Mitologjia/Folklori/Letërsia, “Naim Frashëri”, Tiranë.

kjë qëndresë po na kushton shtrenjtë dhe ndoshta do të na kushtojë edhe më shtrenjtë. Por dikush duhet të qëndrojë. Në rrugën e e hordhisë së çmendur gjithmonë duhet të çohet dikush dhe këtë herë koha n zgjodhi ne. Koha na vuri përpara dy rrugë: rrugën e lehtë të nënshtrimit dhe rrugën e rëndë të luftës. Ne zgjodhëm të dytën. Ne mund të zgjidhnim të parën, në qoftë se do të mendonim vetëm për veten tonë. Ne mund t'i ngrysim ditët tona në paqe, pranë parmendës dhe ullinjve, - por kjo do të ishte paqe e vdekjes”.

Dhe, në kronikën para kapitullit të fundit bien daullet e shiut. Kampi i tyre i zhurmshëm merr pamje tepër të zymtë “Ja, pra, kjo është ushtria më e madhe e botës së sotme. Ajo rri aty nën këmbët tona, duke u qëlluar në shi. Ata që do të jetojnë më vonë mbi këtë tokë do ta kuptojnë se ne nuk e patëm të lehtë të ngriheshim në këtë luftë vigane kundër përbindëshit më të madh të kohës. Ne nuk do të lëmë pas statuja dhe kolona madhështore. S’patëm kohë dhe, me sa duket, në pushimet midis rrebesheve që do të vijnë, s’do të kemi kohë t’i bëjmë ato. Në vend të tyre po lëmë këta gurë të rëndë muresh që po i lag këtë mëngjes të vrenjtur nga ky shi i luftës”

Kjo është njëra anë, njëri kënd shikimi: i madhërishtëm, monumental e solemn, aq sa mund të jetë solemne një “stinë” lufte, jeta e një populli të tërë e kaluar në luftë e në rrethime.

Romani “Kështjella” në shumanshmëri e me një thjeshtësi e qartësi të rrallë flet shumë edhe për këtë çështje. Këndi tjetër i shikimit është paraqitja mjaft e hollësishme e gjendjes së ushtrisë osmane e, përmes tyre, e rendit ekonomik, shoqëror e politik të Perandorisë Osmane në atë kohë.

Për vërtetësinë e hollësive ekonomike, politike, administrative, ushtarake historianët mund të thonë më me kompetencë fjalën e tyre, por për ne ka rëndësi se në drejtimet kryesore autori i përmbahet së vërtetës historike dhe e ka pasqyruar atë me shprehimësi të madhe artistike, deri dhe me nuanca të gjendjeve psikologjike e morale. Ndërsa “Kështjella” është vepër me përmbajtje atdhetare për qëndresën shqiptare dhe kuptimin historik të saj tej kohës e vendit.

Ali Pashë Tepelena nga Sabri Godo

Autori: «Koha që jam marrë me Ali Pashën e Tepelenës shkon në tridhjetë e pesë vjet, natyrisht në periudha të caktuara. Për mua ai ishte një figurë që nuk mund të mposhtet dhe që ka gjithmonë diçka për të thënë.

Tani e hoqa qafe, por edhe ai mua. Nuk u përpoqa t’i bëja imazhin, po ju them të vërtetën. Arti dhe kërkimet historike nuk kanë fund, por ky është libri që e kam dashur dhe që mund të shkruaj për Aliun; dhe në të nuk kam asgjë për të hequr apo shtuar.»³

Në këtë vepër të bukur stilistike, vlerësimi i figurës së Ali Pashë Tepelenës zë një vend qendror në hapësirën problematike historike, me aludime të shumta për epokën tonë. Historiografia jonë ka bërë përpjekje të konsiderueshme për ta trajtuar këtë figurë. Ndër veprat më të plota dhe me vlerë është libri “Ali Pashë Tepelena” i Sabri Godos, i shkruar me mjeshtëri, njohuri të thella dhe mjeshtëri.

Ndër udhëtarët që na kanë lënë kujtime të errëta të takimeve me Ali Pashë Tepelenën, një vend të veçantë zë padyshim anglezi (Henri Holland), për faktin se u bë mjeku dhe këshilltari i besuar i Vezirit të ashpër të Janinës.

Vizita e Henry Holland nuk mori pjesë në misione sekrete. Djali anglez ishte diplomuar për mjek në Edinburg dhe ishte në një udhëtim 18-mujor përmes Portugalisë dhe Spanjës, në Shqipëri, Greqi dhe Turqi. Hollanda, përveçse mjeku, kishte njohuri nga gjeologjia, kimia dhe arkeologjia.

Holland nuk ka frikë ta quajë Ali Pashën tiran, por në të njëjtën kohë e justifikon me nevojën për t’u përballur me anarkinë feudale. Diçka që u ndje qartë në ndryshimin e menjëhershëm të situatës ku pushteti i Aliut u vendos rishtazi, si në Gjirokastrë dhe Vlorë. Ishte një pushtet që Aliu e mbante me të gjitha mjetet. Holland kishte parë gjurmët e masakrës së tmerrshme të Hanit të Valares, ku u masakruan 800 banorë të fshatit Kardhiq. Ai shikonte sesi ky fshat ishte i shkrëtë dhe si po i shkatërroheshin shtëpitë, për të ndëshkuar një fyerje të rëndë që i ishte bërë nënës dhe motrës së tij, gati gjysmë shekulli më parë. “Hakmarrja e tij – përfundon ai – nuk është një ndjenjë momenti, e cila

³ Sabri Godo(2003), Ali Pashë Tepelena, “Dudaj”, Tiranë.

shuhet kur objekti shkatërrohet, por vazhdon me kalimin e viteve dhe godet për qejfin e tij, edhe fëmijët dhe gjithë rracën e armikut”⁴.

Në ndryshim nga këto cilësi të papranueshme për të riun anglez, ai jep edhe anën pozitive të Aliut: “Mendimi i shpejtë, mprehtësia e rrallë e vëzhgimit, një bashkim energjie dhe vendosmërie në veprim dhe shumë vendosmëri personale, lidhen me aftësinë për dinakëri të pazakontë. Një shkallë lirie nga paragjykimet kombëtare dhe fetare, e cila haset rrallë në mesin e sundimtarëve turq. Ai ka përqafuar me ndërgjegje në territorin e tij disa nga përparimet e kombeve më të përparuara. Aliu ka shkatërruar bandat e shumta të grabitësve që po rrënonin banorët e paktë të vendit. Me urdhër të tij u hapën rrugë, u ndërtuan dhe u bënë përpjekje për përmirësime bujqësore”, na bën me dije Holland se Ali Pasha dinte të shkruante turqisht dhe greqisht. Ai ishte i interesuar për çështje që kishin të bënin me përmirësimin e brendshëm të territorit të tij, ndërtimin e rrugëve dhe urave, zbulimin e minierave, përmirësimin e bujqësisë dhe çështje të tjera.

Mënyra se si Aliu komunikonte me luftëtarët shqiptarë ishte miqësor, Aliu i trajtonte si miq, i njihte me emër, meritat dhe familjet e tyre dhe i shpërblente me dhuratat më bujare. Edhe të huajt, sipas të dhënave bibliografike, kanë shkruar shumë për Ali Pashë Tepelenën. Letërsia me jehonë e bukur dhe të kujdesshme që i bën kështjellave e legjendave është një burim i rëndësishëm edhe në funksion të turizmit duke i ardhur në ndihmë udhërrëfyesve turistike që të përcjellin historitë e bukura, traditat dhe legjendat e lashta të vendit dhe popullit tonë.

BIBLIOGRAFIA

- GJERAK KARAISKAJ (1981), 5000 vjet fortifikime në Shqipëri, Shtypshkronja e re, Tiranë. 2. MARIN BARLETI (1981), Rrethimi i Shkodrës, Shtypshkronja e re, Tiranë.
- NERITAN CEKA (2006), Udhëtim në kështjellat ilire, Migjeni, Tiranë.
- ALFRED UÇI (-), Mitologjia/Folklori/Letërsia, “Naim Frashëri”, Tiranë.
- ALEKSANDËR STIPÇEVIQ (2002), ILIRËT/Historia, jeta, kultura, simbolet e kultit, “Toena”, Tiranë.
- SABRI GODO(2003), Ali Pashë Tepelena, “Dudaj”, Tiranë.
- HENRY HOLLAND(2008), Mjek Te Ali Pasha, “Migjeni”, Tiranë.

⁴ Henry Holland(2008), Mjek Te Ali Pasha, “Migjeni”, Tiranë.